



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më datë 03.06.2022

VENDIM

Nr. 222. datë 03.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenin 10, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të sondazheve arkeologjike realizuar nga individ i licencuar në arkeologji, z. Skënder Mucaj , në kuadër të projektit “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1,5 dhe 6 kate me 1 kat banimi nëntokë*”, Zona arkeologjike ‘B’ Durrës, me aplikues Skënder Mucaj dhe zhvillues C-D-Group;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike për projektin *Godinë banimi dhe shërbimesh 1,5 dhe 6 kate me 1 kat banimi nëntokë*” si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Rezultatet e sondazheve arkeologjike të paraqiten për shqyrim dhe vendim-marrje në mbledhjen e radhës së Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

